


## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

në mes të

DEMOKRACI PLUS (D+)

dhe

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS



D+ me mbështetjen e USAID Aktiviteti i Drejtësisë, janë angazhuar në vlerësimin e zbatimit të drejtësisë procedurale në njëzet (20) degët në Kosovë (Podujevë, Graçanicë, Lipjan, Glogoc, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Dragash, Suharekë, Leposavic, Vushtri, Zubinpotok, Skenderaj, Malishevë, Rahovec, Istog, Klinë, Decan, Kacanik, dhe Shterpce). Përqëndrimi do të jetë në mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre në lidhje me përvojën e drejtpërdrejtë të qytetarëve me cilësinë e shërbimeve të gjykatave si dhe monitorimin e seancave gjyqësore.

Përmes këtij memorandumi, mundësohet monitorimi i drejtpërdrejtë i punës së njëzet (20) degëve të gjykatave themelore, si dhe mbledhja e të dhënave nga përdoruesit (qytetarët) e shërbimeve në gjykata.

Mbledhja e të dhënave do të mundësoj:

1. Zhvillimin e dy studimeve mbi nivelin e zbatimit të drejtësisë procedurale;
2. Zhvillimin e shtatë raporteve me rekomandime konkrete për përmirësimin e drejtësisë procedurale në të gjitha degët e gjykatave.

Palët nënshkruese zotohen si në vijim:

**D+ do të:**

- Caktojë një pikë kontakti për bashkëpunim me degët e gjykatave;
- Njoftoj Gjykatën për monitorueset/it e përfshirë në zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projektit;
- Respektoj parimin e konfidencialitetit dhe fshhtësinë e proceseve gjyqësore në rastet që monitorojnë;
- Grumbullojë të dhëna të cilat do të analizohen dhe paraqiten si të dhëna grupore dhe në mënyrë objektive me qëllim të ofrimit të rekomandimeve për përmirësim të kualitetit të shërbimeve që u ofrohen përdoruesëve;
- Ruajë të dhënat personale të personave të përfshirë në proceset gjyqësore;

Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të:

- Caktojë një pikë kontakti në secilën degë për bashkëpunim me D+;
- Lejojë qasje të papenguar në ambientet publike të gjykatës për monitoruesit/et e D+;
- Ofrojë qasje në orarin e seancave të planifikuara dhe qasje në seancat gjyqësore për monitoruesit/et e D+.

Ky memorandum hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të jetë në efekt deri 30 nëntor, 2022. Marrëveshja mund të amendamentohet në çdo kohë me pëlqimin e të dyja palëve.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:



Albert Zogaj, Kryesues

Datë:

21.10.2022

Për D+:



Valmir Ismaili, Drejtor i D+

Datë:

21.10.2022